

HOME > NEWS

Njoftim për shtyp 11 Qershor 2020

11 June, 2020 by **KLJGJ** in **NJOFTIME PËR SHTYP**

Sot me datë 11.06.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi mbledhjen plenare të radhës në të cilën shqyrtoi disa çështje të rëndësishme.

Në funksion të plotësimit të skemës së vlerësimit të gjyqtarëve dhe me qëllim nisjen e shpejtë vlerësimit periodik, Këshilli vendosi miratimin e rregullave për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, fillimin e procedurës së vlerësimit etik e profesional dhe caktimin nëpërmjet shortit të relatorit dhe nëpunësit përgjegjës, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit) të 18 gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit.

Në vijim Këshilli miratoi dhënien e komenteve dhe kundërshtimeve për raportin e Shkollës së Magjistraturës për rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, për vitin akademik 2020-2021, profili gjyqtar.



Më tej Këshilli vendosi miratimin e rregullores për funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.

Në përputhje me rendin e ditës, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, si dhe caktimin e relatorit përkatës për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.83 dhe nr.86, datë 26.02.2020.

Me qëllim garantimin e funksionalitetit të disa gjykatave në vend, Këshilli vendosi përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit Gentian Marku në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares Rezarta Paja Aliu në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares Diamela Goxha në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit Genti Dokollari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Në fund, në vijim të shqyrtimit të çështjes së adresuar nga Presidenti i Republikës lidhur me qëndrimin e mëtejshëm në detyrë si anëtar i Gjykatës së Lartë të z. Ardian **Dvorani**, Këshilli vendosi përfundimin e detyrimit të z. **Dvorani** për të ushtruar mandatin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, si dhe njoftimin e tij për të ushtruar të drejtën për emërim si gjyqtar në një nga gjykatat e apelit të vendit.







